



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2021, mori në shqyrtim praktikatat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi licencimin e shoqërisë “Rei – Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Lingjance 1” me kapacitet të instaluar 1897 kW dhe “Lingjance 2” me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 kW.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Balkgaz” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë.
3. Mbi zgjatjen e afatit të dorëzimit të programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, Albgaz sh.a..
4. Mbi heqjen e licencës nr.63, seria NPM08P, dhënë shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 89, datë 06.08.2008, i ndryshuar.
5. Mbi heqjen e licencës nr.59, seria NPM08P, dhënë shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 63, datë 13.06.2008, i ndryshuar.